



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

Policia Rugore e Dibrës, kontrolle të shtuara në akset rrugore
Policia Kufitare dhe Njësia Policore Detare/Bllokohen 11 mjete të tjera lundruese, për disa shkelje
Sarandë – Finalizohet nga Komisariati i Policisë Sarandë, operacioni policor i koduar “Cash”
Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Delivery”, për goditjen e kontrabandimit të mallrave
DVP Korçë/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 5 të tjerë, për vepra të ndryshme penale



Lajmet

12/09/2023

Tiranë – Procedohet Penalisht 1 Shtetas Që Keqtrajtoi Një Kafshë (Mace)

Tiranë

Në lidhje me një video të postuar në rrjete sociale, në të cilën shfaqet një shtetas duke keqtrajtuar një kafshë (mace), ju sqarojmë se:

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, menjëherë pas publikimit të pamjeve filmike, organizuan punën për identifikimin dhe shoqërimin e autorit.

Në vijim të veprimeve, u shoqërua në komisarariat shtetasi S. K., 39 vjeç, banues në Tiranë. Gjatë kontrollit në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën një armë sportive, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve nisi procedimi penal për shtetasin S. K., për veprat penale “Keqtrajtimi i kafshës”, “Prishja e qetësisë publike” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë falënderon mediat dhe qytetarët që denoncojnë rastet e paligjshmërisë dhe i fton sërish ata që të denoncojnë çdo rast paligjshmërie në Komisariatin Dixhital dhe në numrin 112, duke iu garantuar reagim të menjëhershëm.

◀ Livinë, Finiq – I vuri zjarrin tokës së tij, por ai u përhap duke përfshirë një sipërfaqe shumë të madhe, Policia identifikon dhe shpall në kërkim 36-vjeçarin

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Balcony”, për goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)